

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	“Përgjegjës sektori”	Reparti Ushtarak nr.6029, në Tiranë	Tiranë	Pa afat	Po	Po	10.11.2025	14.11.2025

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: “Përgjegjës sektori”, në Sektorin e Mbështetjes dhe Shërbimeve.
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: në Muzeun e FA-së, Reparti Ushtarak nr.6029, në Tiranë.
4. Vendi: Tiranë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar.
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 10.11.2025
8. Data e mbylljes së aplikimit: 14.11.2025
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kritereve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykate të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- a. Grada/Titulli: **Përgjegjës Sektori, O/C.**
- b. Arsimi : Të ketë diplomë të nivelit minimalisht “Master Shkencor” në shkenca “Shoqërore”.
- c. Kualifikimi: Të ketë kualifikime në fushën e mësipërme.
- d. Trajnimi: Të ndryshme në fushën e kërkuar.
- e. Eksperienca në Punë: Eksperienca pune jo më pak se **3 vit**.
- f. Gjuha e huaj: Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze.
- g. Kërkesa të tjera specifike: Aftësi shumë të mira të punës në grup, planifikuese, si dhe të përdor programeve kryesore të kompjuterit, Word, Excel, Power Point.

h. Niveli i certifikatës së sigurisë: Të plotësojë kriteret për tu pajisur me certifikatë të sigurimit të personelit, sipas VKM nr.188/2015. Certifikatë Sigurie “Secret”.

Përshkrimi i punës: Përgjigjet për mirëfunksionim administratës së muzeut në interes të misionit e detyrave të MFA-së.

Detyrat kryesore:

- Përgatit urdhra e udhëzime, që kanë të bëjnë me përmirësimin e funksionimit të aktiviteteve të administratës së muzeut në interes të misionit e detyrave të MFA-së.
- Organizon punën për zgjidhjen në kohë e në rrugë sa më të shkurtër të problemeve administrative.
- Planifikon e kontrollon procedurat që lidhen me sigurimin e furnizimit, nivelin e gjendjes së furnizimeve në depot sipas nomenklaturës, riplotësimin e gjendjes, administrimin dhe trajtim/mirëmbajtjen e tyre.
- Zbaton parimin e efektivitetit ekonomik duke u kujdesur për përdorimin e fondeve në kohën e duhur dhe me qëllimin e një administrimi sa më efektiv.
- Ndjek ligjshmërinë e veprimtarisë të MFA-së, ndihmon dhe trajnon nëpunësit për zbatimin e akteve ligjore e n/ligjore me gjitha ndryshimet e tyre.
- Organizon punën për funksionimin normal të zyrave në varësi dhe përgjigjet për disiplinën e punës së gjithë nëpunësve dhe punonjësve të administratës.
- Kontrollon punën midis zyrave në vartësi, në funksion të realizimit të qëllimit të përbashkët të punës.
- Merr pjesë në mbledhjet e Drejtorisë së MFA-së dhe realizon detyrat që dalin nga mbledhja e tij.
- Merr pjesë në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për hartimin e projekt-buxhetit në varësi të programit dhe detyrave të përcaktuara.
- Planifikon kërkesa për zhvillimin e infrastrukturës dhe merr masa për përmirësimin e saj.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.